

6 – 8 Nëntor 2013

JAVA KOMBËTARE E UJIT

Java e parë e nëntorit, me anë të VKM Nr 1248 Datë 10.09.2008, është shpallur si **Java Kombëtare e Ujit në Shqipëri** dhe çdo vit organizohen aktivitete të ndryshme në lidhje me ujin..

Uji i pijshëm dhe monitorimi

Burimet e ujit të pijshëm përbëjnë një burim madhor për vendin. Sasia mesatare e ujit të pijshëm për frymë është 8,700 metra kub në vit, një ndër më të lartat në Evropë. Burimet e ujit të pijshëm në vend ekzistojnë në formën e burimeve natyrore, të lumenjve, të liqeneve dhe të ujëmbledhësve të ujërave nëntokësore. Furnizimi me ujë të pijshëm vjen kryesisht nga burimet natyrore dhe burimet ujore nëntokësore, përveç zonës metropolitane të Tiranës e cila një pjesë të furnizimit e merr nga burimet ujore malore që janë devijuar për të krijuar një rezervuar sipërfaqësor furnizimi me ujë që rrjedhimisht duhet trajtuar. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm mbulon të gjithë vendin dhe niveli i mbulimit arrin në 85%.

Siguria e furnizimit me ujë të pijshëm ka të bëjë me mbrojtjen e burimeve ujore dhe klorinimin e ujit në sistemet e shpërndarjes. Shqipëria ka ligje dhe rregullore që trajtojnë mbrojtjen e burimeve natyrore. Kontrolli i cilësisë së ujit në Shqipëri kryhet nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me drejtoritë e shëndetit publik në rrethe.

Çfarë uji duhet konsumuar?

- Gjithmonë duhet konsumuar ujë i sigurt dhe higjienikisht i pastër për shëndetin.
- Ujë i sigurt dhe higjienikisht i pastër është uji që plotëson normat higjieno-sanitare të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- Për çdo shqetësim shëndetësor që mund të vijë nga konsumi i ujit ju mund t'i drejtoheni mjekut të familjes.
- Informacione mbi cilësinë e ujit në zonën tuaj, ju mund t'i merrni pranë drejtorisë së shëndetit publik të rrethit ku jetoni